REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
Nr. Ipsit 5273 Më 23.11.2022
RAHOVEC - ORAHOVAC

KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATË

Numri i kontratës:[1]: **623-22-12160-5-3-6/C435**

Emri i Autoritetit Kontraktues: **KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**, në njërën anë; dhe

Emri i Kontraktuesit: **waterline SH.P.K., Rr.Brigada 123, Suhareke**, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për pune e shënuara me poshtë:

Titulli i Kontratës: **NDËRTIMI I KOMPLEKSIT MEMORIAL NË FSHATIN RETIJË**

Me numër identifikues: **623-22-12160-5-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Ndërtimi i kompleksit memorial në fshatin Retijë,** sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: **datën e nënshkrimit** dhe përfundon për një periudhë **prej 30 ditë**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 5 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë: **Në fshatin Retijë – Komuna e Rahovecit**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP[2] (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

---

[1] Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

[2] DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **7,322.20 €uro;**

[Shtatëmijë e treqindenjëzetenjë Euro e njëzetë Cent]

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.
5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të punëve.

Shume e sigurisë së ekzekutimit është: **732.22 €uro**, për kohëzgjatjen e periudhës prej: **2 muaj** nga data e nënshkrimit të kontratës.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin te kryej ndonjë ose te gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [**Gjykata Themelore Prishtinë**] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [*Shqip*][3] në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues:		**Për Kontraktuesin:**	
Emri:	**Astrit Mullabazi**	**Emri:**	**Kushtrim Kryeziu**
Pozita:	**Menaxher i Prokurimit**	**Pozita:**	**Drejtor**
Nënshkrimi:		**Nënshkrimi:**	
Data:	**23.11.2022**	**Data:**	**23.11.2022**
Vula:	REPUBLIKA E KOSOVES Komuna Rahovecit Drej. për Administratë të Përg. RAHOVEC OPSTINA	**Vula:**	waterline Design, Construction, Plumbing and HVAC Company SUHAREKE - KOSOVE

[3] Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Paramasa dhe Parallogaria

KOMPLEKSI MEMORIAL NË FSHATIN RETIJ

Verejtje: Kontraktori duhet patjeter t'iu referohet specifikimeve gjenerale dhe detaleve. Çmimet duhet te përfshijnë furnizimin, transportin dhe instalimin/finalizimin e të gjitha materialeve. Kontraktori duhet të dorëzoj deklaratat e konformitetit për të gjitha materialet e përdorura në këtë projekt. Për të gjitha punët e ekzekutuara, patjetër duhet të bëhen testet paraprake.

POS.	1. PUNËT PËRGATITORE				
1	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.1	Mobilizimi i ndërmarjes , Rethimi i punishtes për ekzekutimin e punimeve në Pastrimin e dheut dhe ndërtimin e kompleksit memorial.	Komplet	1.00	100.00	100.00
				Gjithsej POS 1:	100.00

POS.	2. PUNËT E TERENIT DHE GJELBRIMI				
2	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
2.3	Furnizimi,transporti dhe mbjellja e barit anglez ne menyre profesionale me fare 35 m²/3kg fara dhe rrafshim e terrenit me cilinder te dores,furnizimi me pleh kimik dhe sterpikja me uje deri ne mbirjen e barit.	m²	170	4.00	680.00
2.4	Gërmimi i gropave për vendosjen e dheut për drunjet dekorativë dimensionet e hapjes jane 60x60x50cm'. Dheu i tepërt duhet të ngarkohet si dhe të deponohet në deponi të qytetit ne largesi deri ne 10km. Si dhe furnizimi me dheun e pershtatashem per mbjelljen e bimeve dekorativë.	copë	20	10.00	200.00
2.5	Furnizimi transporti si dhe vendosjen e dheut të përshtatshëm për drunjet dekorativë BLINI .dimensionet e gropave jane 60x60x50cm'.	copë	20	10.00	200.00
2.6	Furnizimi transporti si dhe mbjellja e drunjëve dekorativë BLINI (mosha e tyre duhet të jet minimum tre vjeqare para mbjelljes). Druri duhet zevendesohet ne rast se ato deshtojne (thahen) gjithashtu fidanet duhet te mbrohen me listela 3x5cm dhe te sigurohet demtimi fizik deri 1.5m	copë	20	20.00	400.00
				Gjithsej POS 2:	1,480.00

POS.	3. PUNET LYERJES TË BETONIT				
3	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
2.6	Furnizimi transporti si dhe lyerja e mureve të betonit me një shtresë baze adekuate për beton dhe në dy shtresa me ngjyrë finale sllikoni, nuancën e ngjyrës e përcakton investitori.	m²	70	4.00	280.00
				Gjithsej POS 3:	280.00

POS.	4. RRETHOJAT (RRETHIMI I KOMPLEKSIT)				
	RRETHOJA E KOMPLEKSIT (Në çmim te perfshihet saldimi, bulonat.Ngjyra në dy shtresa anti				
4	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali

Waterline Construction Plumbing & HVAC Company SUHAREKE - KOSOVE

4.1	Furnizimi , transportimi dhe montimi I rrethojës metalike me lartësi h = 45 cm . Korniza e rrethojës të punohet , e profile metalike me dim . 40x40x3 mm ' , ndërsa mbushja e rrethojave të punohet me profile prej metali me dim . 30x20x2 mm . Në çmim të llogaritet lyerja me ngjyrë antikorozive dhe me ngjyrë të yndyrshme dhe atë në dy shtresa . Nuancën e ngjyrës e përcakton investitori .	m'	46	30.00	1,380.00
4.2	Furnizimi , transportimi dhe montimi I derës metalike me dimensione 45 * 150 cm ' me dorrez, dhe bagllam te cilesis se larte, cilindri mbylles duhet qe ti kete 3 qelesa . Korniza e derës të punohet me profile prej metali 40x40x3 mm ' , ndërsa mbushja e rrethojës të punohet me profile prej metali 30x20x2 mm ' . Në çmim të llogaritet edhe lyerja me ngjyrë antikorozive dhe me ngjyrë të yndyrshme dhe atë me dy shtresa . Nuancën e ngjyrës e përcakton investitori .	copë	1	100.00	100.00
				Gjithsej POS 4:	1,480.00

POS.	5.PUNET E NDRIQIMIT				
	Pershkrimi I Puneve	njesia	sasia	totali	totali
5.2	Mbyllja e kanalit pas vendosjes se kabllove dhe pjeseve tjera si shiritit paralajmrues etj, me dheun e germuar si dhe nje shtres zhavor me trashesi te zhavorit t=10cm'.Te behet ngjeshja e vendit pas kryerjes se punes (te kthehet ne gjendjen e meparshme)	m³	10.60	5.00	53.00
5.3	Furnizmi, transportimi dhe montimi I kabllit elektrik 3*1.5mm' prej kutis shperndares ne qdo shtyll per ndriqim me te gjitha punet tjera percjellse, kablli duhet te futet ne gypin e brinjezuar Ø 22m', ku ne qmim duhet te perfshihet edhe gypi I brinjezuar dhe te gjitha punet percjellese deri tek funksionalizimi.	m'	30.00	4.00	120.00
5.4	Furnizmi, transportimi dhe montimi I kabllit elektrik 4*6mm' prej rrejtit te qytetit deri ne kutin shperndares, kablli duhet te futet ne gypin e brinjezuar Ø 28m', ku ne qmim duhet te perfshihet edhe gypi I brinjezuar dhe te gjitha punet percjellese deri tek funksionalizimi.	m'	15.00	6.00	90.00
5.5	Furnizmi, transportimi dhe montimi Ishtyllave prej qeliku te galvarnizuar me diameter Ø120mm' dhe lartesi te shtylles h=4m' sipas detajeve te dhena ne projekt, ne qmim duhet te parashifet edhe ankerimi me pllaka qeliku dhe bulna ne bazat e betonit.	copë	3.00	300.00	900.00
5.6	Furnizmi, transportimi dhe montimi I poqave elektrik LLED me min 80 drita te vogla ne nje poq apo te ngjahsme me karakteristika dhe ndriqim te njete, forma dhe dizajni duhen te jene siapas detalit ne projekt.	copë	3.00	20.00	60.00
5.7	Furnizmi, transportimi dhe montimi I shiritit Fe7n 1*3.5mm; per tokezimin e qdo poqi elektri me nje distan nga drit min 2m' si dhe shtangimi ne shtyllen elektrime me bulona adekuat per kete pozicion.	m'	7.50	5.00	37.50
5.8	Furnizmi, transportimi dhe betonimi bazes se shtyllave elektrike me beton te klases C25/30 me dimensione 40*4040 cm' si dhe betonimi I bazes me beton te klases C25/30 se kutis shperndarese me dimensione 40*100*40 cm'me te gjitha punet tjera percjellse.	m3	0.20	300.00	60.00

waterline
Design, Construction, Maintenance and HVAC Company
SJHARENE - KOSOVE

5.9	Furnizmi, transportimi dhe montimi ishirit I kutis shperndarese per ndriqim publik komplet me te qitha paisjet e nevojshme si siguresat automatiki per aktivizimin e dritave ne kohen e caktuar si dhe paisjet tjera, duhet te jet I kompletuar per funksionim te plot.	copë	1.00	100.00	100.00
				Total 5	1,420.50
POS.	6. PUNËT E PLLATOSË				
6	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
6.5	Furnizimi, transportimi dhe montimi I mermerit (TILUS) me trashesi 3cm për bazamak të shkalleve.	m²	10.3	90.00	927.00
6.6	Furnizimi, transportimi dhe montimi I mermerit (TILUS) me trashesi 2cm për balloret të shkalleve.	m²	6.81	70.00	476.70
6.7	mveshja e dyshemesë me pllaka te mermerit me trashesi 1cm për dyshemene e pllatose	m²	20	30.00	600.00
				Gjithsej POS 6:	2,003.70
POS.	7.PUNET E STRUKTURËS METALIKE MBI MEMORIAL				
7.1	Furnizimi , transportimi dhe montimi i emblemës së UÇK-së me dimensione sipas projektit.	copë	1	150.00	150.00
				Gjithsej POS 7:	150.00
POS.	8.PUNËT E GRANITIT				
8.1	Furnizimi, transportimi dhe montimi I pllakes se graniti te cilat duhen te montohen ne pelhurat e betoni (memoriali) ku do te gdhenden emrat e te gjith martireve, graniti duhet te jet me trashesi t=3cm' si dhe ngjyra e granitit duhet te jete e zeze, pllaka e granitit duhet te ngjitet ne pelhuren e betonit me llaq qimento apo silikon specjal kunder ndyshimeve klimatike si dhe ne gjashte vende duhet te perforcohet edhe me bulona me tipla ku graniti duhet ti hapen vrimat Ø16mm' I cili duhet te ankerohet min 10 cm' ne beton.	m²	10.2	40.00	408.00
				Gjithsej POS 8:	408.00
	REKAPITULIM				
1	PUNËT PREGADITORE			€	100.00
2	PUNËT E TERENIT DHE GJELBRIMI			€	1,480.00
3	PUNET LYERJES TË BETONIT			€	280.00
4	RRETHOJAT (RRETHIMI I KOMPLEKSIT)			€	1,480.00
5	PUNET E NDRIQIMIT			€	1,420.50
6	PUNËT E PLLATOSË			€	2,003.70
7	PUNET E STRUKTURËS METALIKE MBI MEMORIAL			€	150.00
8	PUNËT E GRANITIT			€	408.00
			TOTALI:	€	6,205.25
			TVSH 18%	€	1,116.95
			TOTALI ME TVSH:	€	7,322.20

Waterline
Construction, Plumbing and HVAC Company
SUHAREKE - KOSOVE